



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Numri i lëndës: 2023:283075  
Datë: 21.11.2024  
Numri i dokumentit: 06489329

**Kom.Dh.Shk.II.nr.2121/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** – Dhoma e shkallës së dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtare të kolegjit, në çështjen juridike - konfliktin administrativ sipas propozuesit – paditësit A.H. B.I, fshati Caralluk, komuna e Malishevës, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Bekim Kryeziu, kundër kundërshtares së propozimit - të paditurës Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, me bazë juridike për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, nr. 01.3.2.2/24160, 24611 datë 10.11.2013, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit - propozuesit kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti Fiskal KF.nr.682/23, të datës 25.10.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21.11.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e propozuesit – paditësit A.H. B.I, fshati Caralluk, komuna e Malishevës, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti Fiskal KF.nr.682/23, të datës 25.10.2024, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m i**

Me aktvendimin e Gjykatës Komerciale Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti Fiskal, në pikën I të dispozitivit është refuzuar propozimi- kërkesa e A.H. B.I, fshati Caralluk, komuna e Malishevës, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të aktit administrativ përfundimtar - vendimit me nr. 01.3.2.2/24160, 24611 datë 10.11.2013 të të paditurës, Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë. Në pikën II të dispozitivit është caktuar se procedura sipas padisë në këtë konflikt administrativ do të vazhdojë sipas rregullave të procedurës në konfliktin administrativ dhe sipas planit të punës së Gjykatës.

Kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale Dhomat e Shkallës së parë, A.H. B.I, fshati Caralluk, komuna e Malishevës, përmes të autorizuarit avokat Bekim Kryeziu, për shkak të

shkeljes së dispozitave të procedurës dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që gjykata e shkallës së dytë aktvendimin e kontestuar ta ndryshon dhe të aprovojë kërkesën e paditësit, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurës.

Kolegji i Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, dhe pas vlerësimit të aktvendimit të kundërshtuar në pajtim me nenin 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për konfliktin administrativ (LKA), ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar.

Duke shqyrtuar shkresat e lëndës, aktvendimin e kundërshtuar sipas ankesës së kunderpropozuesit-te paditurës, kolegji i kësaj gjykate, gjen se Dhomat e Shkallës së Parë, pas shqyrtimit të propozimit të paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit me nr. 01.3.2.2/24160, 24611 datë 10.11.2013 të Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, ka gjetur se propozimi i tillë është i pabazuar, ngase paditësi - propozuesi nuk e ka bërë të besueshme përmes provave të prezantuara, nuk ka arritur të vërtetoj se është përmbushur kushti i rrezikut serioz dhe dëmi i riparueshëm, si dhe se ekziston rreziku i shkakut të dëmit apo humbjeve të tjera, nëse nuk caktohet shtyrja e ekzekutimit të vendimit kontestues, ashtu siç është përcaktuar në nenin 22, paragrafi 6 e lidhur me paragrafin 2, të këtij neni, të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA).

Kolegji i Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshme një konkludim të tillë të gjykatës së shkallës së parë ngase edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par. 6 lidhur me par. 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, i cili përcakton se: “ me kërkesë e paditësit, organi akt i te cilit ekzekutohet gjegjësisht organi qe është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do të sillte dem paditësit, i cili vështir do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, as që shtyrja do të sjellte ndonjë dem të madhe palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar”.

Gjykata e Shkallës së parë në vendimin e saj, ka konstatuar se paditësjat në pretendimet e saja nuk i ka arsyetuar mjaftueshëm se të njëjtat janë të bazuara në Ligj dhe se në rastin konkret nuk janë përmbushur kushtet Ligjore që të aprovohet propozimi për shtyrje të ekzekutimit të vendimit deri sa gjykata të vendos përfundimisht lidhur me Ligjshmërinë e vendimit të kontestuar përkitazi me padinë e paditësit e në kuptim të nenit 22 të LKA-se.

Me që nga provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës rezultojnë se me vendimin nr. nr. 01.3.2.2/24160, 24611 datë 10.11.2013 të Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, këtu propozuesit, i është refuzuar kërkesa për rishqyrtimin e aktvendimit nr.03.1.1-2023-202 të datës 10.10.2023 të lëshuar nga sektori i kontrolleve pas importuese, si e pabazuar dhe ka mbetur në fuqi aktvendimi i shkallës së parë të organit të administratës, Sektori i Kontrollës Pas Importuese, me të cilin vendim obligohet subjekti në procedure (këtu pala paditëse - propozuese) që në afat prej 10 ditëve të paguaj obligimin doganor në lartësi prej 34,363.18 euro dhe në rast të mos pagesës de detyrimit brenda afatit të caktuar është përcaktuar se do të zbatohet kamate vonesa në lartësi prej 7.80% vjetore apo 0.65 % mujore, e po ashtu është përcaktuar se ankesa nuk e

ndalon ekzekutimin e vendimit. Me tej nga vendimi i atakuar pranë organit të administratës rezulton se, këtu e paditura vendimin e ka marre, pas kontrollit realizuar te pala paditëse.

Duke i marrë parasysh pretendimet ankimore të propozueses- paditëses, në ankesë të cekura më lartë ndaj aktvendimit të shkallës së parë se me ekzekutimin e vendimit të atakuar do të i shkaktohet dëm i pariparueshëm propozuesit i cili do të shkaktonte dëme të madhe financiar dhe për faktin se nuk qëndrojnë konstatimet e te paditurës ne aktvendimin e atakuar, kolegji vlerëson se të njëjtat janë jo të vërtetuara, të pamjaftueshme dhe jo bindëse për tu aprovuar ankesa.

Derisa pretendimet ne padi dhe përgjigje ne ankese te palës paditëse, me te cilat është kërkuar caktimi i masës së përkohshme për shtyrjen të ekzekutimit të aktit administrativ, të atakuar deri në vendosjen sipas padisë së paditësit janë të bazuara dhe se vlerësimi i kolegjit është se janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit siç parashihet në nenin 6 dhe 22 par.2 të LKA-së.

Mbi këtë gjendje të fakteve kolegji gjen se Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale dhe nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesit me rastin e refuzimit te propozimit për shtyrjen e ekzekutimit te vendimit dhe se pretendimet ankimore janë të pa ndikim për vendosje në mënyrë tjetër, andaj ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën b) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhoma e shkallës së dytë**  
**Kom.Dh.Shk.II.nr.2121/24 me datë 21.11.2024**

**Kryetari i kolegjit-Gjyqtari**  
**Faton Bajrami, d.v**